

VENDIM
Nr.1003, datë 30.9.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, NË
UNIVERSITETIN “EQEREM ÇABEJ”, GJIROKASTËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1. 2.1, 29 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në universitetin “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë, në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, në bashkëpunim me Universitetin e Maceratës, Itali, të programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë “Arkeologji dhe administrim i pasurive arkeologjike”.

2. Në përfundim të këtij programi studimi të ciklit të dytë lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, e përbashkët, në “Arkeologji dhe administrim i pasurive arkeologjike”.

3. Ky program studimi i ciklit të dytë realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është dy vite.

4. Programi i studimit “Arkeologji dhe administrim i pasurive arkeologjike” ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha